



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3807 Prot.

Roskovec, më 30.07 2020

VENDIM

NR 56 .DATË 28.07 .2020

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 37 DATË 29.05.2020 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E TREGUT PUBLIK NË BASHKINË ROSKOVEC”

Bazuar në nenin 54, shkronja “k”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 7 pika 1 dhe nenit 15, pika 3, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e një ndryshimi në tekstin e rregullores për funksionimin e tregut publik, bashkëlidhur vendimit Nr.37, datë 29.05.2020, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të tregut publik në Bashkinë e Roskovecit.
- 2- Në tekstin e rregullores së tregut, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:
 - Në nenin 12, pika 1 Masat ndëshkuese, ndryshohet gërma d) me përmbajtje si vijon:
“d) Moslejim i ushtrimit të aktivitetit në tregun publik dhe largim me forcë të mallit dhe tregëtarit nga tregu.”
- 3- Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

